

Çmimi vjetor për angazhim qytetar

KRITERET E PËRGJITHSHME

Kontributi i vazhdueshëm në avancimin e çështjeve të komunitetit (20 pikë)

- Angazhim proaktiv duke demonstruar ndryshime dhe përmirësime pozitive të brenda komunitetit
- Propozim i projekteve apo nisma të zbatuara nga të cilat kanë përfituar drejtpërdrejt qytetarët e një komunitetit të caktuar

Nxitja e bashkëpunimit në komunitet dhe avancimi i partneritetit me organet komunale (15 pikë)

- Angazhim i vazhdueshëm për të rritur komunikimin dhe mobilizuar komunitetin për çështjet me interes të përgjithshëm në kuadër të komunitetit
- Angazhim i vazhdueshëm me grupe të ndryshme të komunitetit, organizata dhe individë
- Angazhim për të rritur partneritetin dhe për të adresuar sfidat lokale në mënyrë bashkëpunuese me organet komunale

Prezantimi i ideve të reja dhe zgjidhjeve kreative (5 pikë)

- Prezantimi i ideve apo zgjidhjeve inovatore për të adresuar çështjet e komunitetit
- Aplikimi i një qasje kreative për zhvillimin dhe advokimin për çështjet e komunitetit në raport me organet komunale

Qëndrueshmëria dhe konsistenca e angazhimit për interesin publik (5 pikë)

- Kontributi që idetë për projekte dhe nismat të promovojnë mirëqenien afatgjatë të komunitetit
- Të ketë demonstruar përpjekje për të siguruar ndikimin e vazhdueshëm pozitiv të punës së tyre
- Të jetë angazhuar në mënyrë konsistente për interesin e përgjithshëm në kuadër të komunitetit

Komunikimi efektiv dhe Avokimi për interes të komunitetit (5 pikë)

- Komunikimi në mënyrë efektive për qëllimet dhe nevojat e komunitetit me organet komunale
- Ka inicuar komunikimin brenda komunitetit për të identifikuar nevojat e komunitetit si dhe i ka adresuar ato kërkesa përmes rrugëve zyrtare të komunikimit në raport me organet komunale
- Avokimi për çështjet e komunitetit në raport me organet komunale, përmes kontributit në procesin e konsultimeve publike si dhe pjesëmarrjen në takimet publike apo takime të përbashkëta me zyrtarët komunal

KRITERET E VEÇANTA

Pjesëmarrja aktive në proceset publike në kuadër të komunës (20 pikë)

- Të jetë përfshirë në mënyrë aktive në proceset e vendimmarrjes publike në nivelin lokal të qeverisjes, përmes forumeve, konsultimeve ose metodave të tjera të pjesëmarrjes së qytetarëve

Avancimi i komunikimi brenda komunitetit dhe avokimi për aktivizmin qytetar (10 pikë)

- Nxitja e komunikimit dhe bashkëveprimit për iniciativat e komunitetit, për të rritur angazhimin e qytetarëve për të adresuar çështjet e komunitetit, përmes takimeve të përbashkëta, forumeve të diskutimit, propozimit të ideve për përmirësim të kushteve në komunitet
- Promovimi i rëndësisë së pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes lokale

Pjesëmarrja aktive në procesin e vendimmarrjes lokale (10 pikë)

- Pjesëmarrje aktive në proceset e vendimmarrjes lokale, duke përfshirë procesin e planifikimit buxhetor dhe procesin e konsultimit publik për politikat lokale
- Angazhim dhe kontribut që perspektivat e reprezentuara të komunitetit të jenë pjesë përbërëse e politikave programore në vetëqeverisjen lokale

Avokimi dhe rritja e partneritetit me Komunat (10 pikë)

- Avokim për interes të komunitetit si dhe adresimin e kërkesave të komunitetit tek komunat
- Pjesëmarrje aktive në takimeve të përbashkëta me zyrtarët komunal për të adresuar çështjet e komunitetit
- Përfshirje në iniciativat dhe projektet e përbashkëta me komunën të cilat kanë pasur një impakt pozitiv në komunitet
- Përfshirje aktive në kampanja avokuese për çështjet e komunitetit